



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:075388

Datë: 26.07.2019

Numri i dokumentit: 00429786

P.nr.153/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me zyrtaren ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit..., Komuna e Gj..., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.195/19, të datës 06.02.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 26.04.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me numër ND...../2019, e datës 16.07.2019, e arritur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjilan në mes të pandehurit ....dhe të dëmtuarës.....,
- II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.II.nr.195/2019, e datës 06.02.2019 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të..., nga fshati, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, për shkak se i pandehuri dhe e dëmtuara kanë arritur marrëveshjen për ndërmjetësim.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 11.02.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.195/2019, kundër të pandehurit..., Komuna e Gj... t, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës.

Gjykata sipas detyrës zyrtare dhe duke u bazuar edhe në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjin për Ndërmjetësim me numër 06/L-009, çështjen penale me numër P.nr. 153/2019, kundër të pandehurit B... U.. nga fshati B..., Komuna e Gj..., për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, e ka dërguar në procedurën e ndërmjetësimit, me çrast me datë 16.07.2019, pranë zyrës për ndërmjetësim në këtë gjykatë është arritur marrëveshja me numërr Nd.../2019, sipas të cilës i pandehuri e ka

pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe një kohësisht të dëmtuarës ...- Distrikti në Gj..., i ka bërë kompenzimit e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 402.00 € si pasojë e veprimeve të tij ndërsa e dëmtuara pas kompensimit të dëmit nga ana e të pandehurit ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit dhe se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike ndaj tij sepse kompenzimin e dëmit tanimë e kanë realizuar.

Andaj gjykata duke u bazuar në të lartcekurat si dhe në bazë të nenit 358 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafi 2 të KPP-së dhe nenit 2, 4, 8, 14, të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.153/2019, me datë 26.07.2019

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.